

Nr. ___ Prot/ Nr. 9 Regj.Durrës, më 20.04.2026**Drejtuar:** Qendra “Res Publica”

person juridik i regjistruar në gjykatë
me Vendimin nr. 604 dt. 13.04.2010,
përfaqësuar nga Z. Dorian Matlija

Adresa: Blv “Gjergj Fishta”, Nd.24, H.3, Ap.7

Email: qendra.respublica@gmail.com

Lënda: Kthim përgjigje mbi kërkesën për informacion

Në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, si dhe në përgjigje të kërkesës suaj me nr. prot. 53/26, datë 08.04.2026, me objekt “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit”, e regjistruar në regjistrin e “Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve”, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji, me numër rendor 9, ju informojmë si vijon:

1. Mbi gjendjen aktuale të punimeve të Hekurudhës Tiranë–Durrës me zgjatim në Rinas:

Aktualisht janë të realizuar mbi 97 (nëntëdhjetë e shtate) % të punimeve civile të kontratës së parë të punimeve ndërtimore të projektit “Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Durrës-Terminali i Transportit Publik Tiranë (PTT) dhe ndërtimi i gjurmës së re Hekurudhore në drejtim të Areoportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA). Punimeve ndërtimore priten të përfundojnë në të gjithë linjën e kontratës së parë, në fund të vitit 2026.

2. Mbi statusin e ndërtimit të godinave të stacioneve:

Ndërtimi i godinave të stacioneve hekurudhore, përbën komponentin e dytë të projektit të rehabilitimit të thelluar të linjës hekurudhore “Durrës- Tiranë- Rinas”. Punimet avancojnë me ritme të kënaqëshme, sipas parashikimeve të bëra në fazën fillestare të këtij projekti. Aktualisht ka përfunduar ndërtimi i godinave në të gjithë stacionet (me përjashtim të Durrësit) dhe është duke u punuar për instalimet elektro-mekanike dhe shtresat në sheshet e jashtme. Për godinen e pasgjereve në Durrës u gjykua gjatë fazës së zbatimit se ishte me e pershtatshme ndërtimi i ri në vend të rikonstruksionit të godinës ekzistues. Ndërtimi i godinës së re ka filluar dhe sapo kanë përfunduar themelet. Në total kontrata e godinave të stacioneve është realizuar në nivelin rreth 50%. Pritet që në fillim të gjashtë mujorit të dytë të vitit aktual këto godina, të merren në dorëzim, pra të finalizohet dhe ky komponent i projektit.

3. Mbi zgjatimin e hekurudhës drejt Bulevardit të Ri në Tiranë:

Projekti “Zgjatimi 4 Km nga Terminali Publik Tiranë (PTT) deri në Qendër të Tiranës (Tirana City Center TCC), është një projekt i ri, i ndryshëm nga projekti ekzistues. HSH ka siguruar investimin me fondet e buxhetin shtetëror dhe po vijon me finalizimin e procedurave të prokurimit për çeljen e garës ndërkombëtare për përzgjedhjen e kontratorit të zbatimit të punimeve. Stacioni fundor në Tiranë do të jetë në Bulevardin e Ri të Tiranës (pranë ish-stacionit të Trenit).

4. Mbi pritshmëritë për vitin 2026:

Për sa i përket dy komponentëve të parë të projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore “Durrës-Tiranë- Rinas”, të dyja kontratat do të jenë të finalizuara deri në fund të vitit aktual. Kontrata e Elektrifikimit , si komponent shtesë i projektit pritet të nisë gjithashtu zbatimin, brënda këtij viti kalendarik.

5. Mbi interesin për operimin koncesionar të hekurudhës:

Operimi i linjës së rehabilituar hekurudhore është një fazë e mëvonshme. Aktualisht nuk ndodhemi në rrethanat ku mund të informojmë për kompanitë e operimit.

**Autoriteti publik “Hekurudha Shqiptare” Sh.A, angazhohet në garantimin e të drejtës së informimit, si garanci kushetuese dhe vepron në mbështetje të Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të Drejtën e informimit” (i ndryshuar) dhe trajton kërkesën tuaj në përputhje me Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Me konsideratë!

KOORDINATORE E TË DREJTËS SË INFORMIMIT
Paula VATNIKAJ

